

SADAT AGUSHI

STUDIMET E VACLAV CIMOHOVSKIT PËR GJUHËN SHQIPE

811.18:811.1/.2

811.1/.2:811.18

Abstrakt: Ky punim trajton veprimtarinë shkencore të albanologut polak Vaclav Cimohovski (Waclaw Cimochoowski), i cili ka dhënë një kontribut të rëndësishëm për albanologjinë.

Studimi i tij për të folmen e Dushmanit (një hapësirë e izoluar malore në Shkodër) ishte pritur mirë në fushën e gjuhësisë sidomos në atë të dialektologjisë. Autori, pas hulumimit nëpër terren kishte arritur t'i nxjerrë e t'i shënojë karakteristikat gjuhësore duke dhënë një përshkrim tërësor e të hollësishëm të një të folmeje të veriut.

Ai ka bërë studime në fusha të ndryshme të shqipes, kryesisht nga fonetika dhe gramatika historike, është marrë me historinë e sandhit në shqipen, gjegjësisht mbi zhvillimin e bashkëtingëlloreve indoevropiane *g(h)* dhe *d(h)* etj. Me argumentet e tij shkencore, vërtetoi se gjuha shqipe është mjaft e vjetër dhe e trashëguar nga ilirishtja. Ai nuk ka shkruar aq shumë për shqipen, por studimet e tij kanë zgjuar një interesim në fushën e albanologjisë.

Fjalët kyçe: veprimtaria jetësore, e folmja e Dushmanit, pozita e shqipes, marrëdhëniet e saj, prejardhja, sistemi gramatikor.

Kontribut të rëndësishëm në fushën e albanologjisë, krahas studiuesve të tjerë të huaj si N. Jokl, H. Pedersen, P. Kretschmer, G. Mejer, M. Lamberc etj., ka dhënë edhe albanologu polak Vaclav Cimohovski. Punimet e tij fillimisht, i kishte bërë në revistën "Lingua Poznaniensis", (e cila dilte në disa gjuhë të huaja e në polonisht) ku botonte artikuj e studime për shqipen. Ai ka lindur më 1912 në Kurk të Rusisë, ku më vonë u shpërngul në Vilnius dhe vijoi studimet e mesme dhe të larta më vonë. Studimet indoevropiane i ndoqi në drejtimin e indoevropistit Jan Otrebski, e më vonë te Paul Kretschmeri e N.S. Trubeckoi dhe te N. Jokli. Është marrë me histori të gjuhës shqipe, me studime krahasimtare-indoevropiane etj. Ka punuar si profesor i gjuhësisë indoevropiane dhe teorike në Poznań. Punoi edhe në Universitetin e Torunit dhe të Gdanjskit. Vdiq më 4 korrik 1982. Veprimtaria e tij studimore shtrihet në dy rrafshë: në rrafshin diakronik dhe në studimet e sotme të shqipes.

Monografia "E folmja e Dushmanit" (La dialecte de Dushmani) është një vepër kapitale ku autori në mënyrë të detajuar jep përshkrimin e një të folmeje. Hulumtimin në këtë krahinë malore në Shkodër e kishte bërë më 1937 dhe aty kishte verifikuar disa dallime të vogla gjuhësore ndërmjet brezit të moshuar, të mesëm e të ri. Pas qëndrimit të tij tetëmuor, ai kthehet në Vilnius (Poloni) dhe fillon punën në shqiptimin e materialit të mbledhur, mirëpo për shkak të Luftës së Dytë Botërore, libri u botua më 1951¹. Libri në fjalë është i ndarë në tri pjesë: fonetikë, morfologji dhe sintaksë kurse pjesa e leksikut nuk ishte përfshirë fare. Nga fusha e fonetikës, ai shënon zanoret gojore (të shkurtëra, të gjata e gjysmë të gjata) e diftongjet. Zanoret hundore sipas tij janë gjithmonë të gjata dhe se në këtë të folme ato artikulohej njëjtë

¹Waclaw Cimochoowski, Le dialecte de Dushmani, description d'un des parles d'Albanie du nord, Poznańskie Tożarzysto Przyjaciol Nauk. Prace Komisiji Filologicznej, XIV, 1, Poznań 1951, f.233

sikurse në tërë pjesën veriore. Ai dha një përshkrim të zanores *ë*, e cila për nga natyra është një vokale që pëson ndryshime nga tingujt fqinjë *k*, *g*, *u* dhe merr ngjyrim (timbër) të *u*-së. Para bashkëtingëlloreve *r*, *l*, *m*, *n*, në rrokjet fundore të patheksuara del si *e* e shkurtër (normale). Ndërkaq nëse pas këtyre konsonanteve paraqitet ndonjë zanore, *e*-ja hiqet (eliminohet) dhe kemi p.sh.: *vjéhër'a*, shq. *vjehr'a*; *mótër*, shq. *mótra*.

Zanorja *ë* në trajtat e gjinore si p.sh.: *nans*, *thmis*, *babs*, *dajs* etj., në gegërishten e Veriut nuk duket para *s*-së kurse shfaqet në toskërishte. Trajtat e emërores dhe të kallëzores në njëjës të emrave mbarojnë me zanore ndërsa në të shquarën vokali *ë* shqiptohet me zgjatim. Disa emra në kallëzore si *lopën*, *motrën*, *ditën* etj., në gegërishten e Veriut paraqiten me *ë* të shkurtër (në Preshevë, mund të shtojmë, kemi: *lopën*, *motrën*, *ditën*) kurse në Jug paraqitet *ë*-ja, (*ën*). Cimohovski këtë zanore e përshkruan si për nga cilësia ashtu edhe për nga funksionet në raport me të folmet e tjera gege e toske. Sipas tij, edhe në të folmen në fjalë, zanorja ka të njëjtin funksion me të folmet e tjera të gegërishtes.

Në pjesën e fonetikës, autori jep një pasqyrë edhe të bashkëtingëlloreve (klasifikimin e tyre, ndarjen) si: buzore, dhëmbore, grykore, lëngëzore, hundore, fërkimore, dhëmbore-frikative, fërkimore-trysore, spirante, afrikate; shënon togjet e bashkëtingëlloreve, jep sqarim rreth theksit etj.

Në sistemin morfologjik, autori përshkruan emrat (gjininë mashkullore, femërore, asnjansë), paradigmën e lakimit të emrave dhe të mbiemrave; përemrat vetorë e vetvetorë, dëftorë, pyetës, pronorë dhe lakimin e tyre; numërorët (themelorë e rreshtorë); paradigmën e zgjedhimit të foljeve, ndajfoljet etj.

Ai shënon folje (paskajore) të cilat përdoren më së shpeshti si: *me u tës*; *me u lūt*; *me u ũl*; *me u djëg*; *me u gər'hāt*, *me u pi*, *me u ankũe* etj. Trajta e pjesores paraqitet gjithmonë me zanore gjysmë të gjatë. Në këtë të folme përdoret koha e tashme, e pakryera, aoristi, e kryera e plotë, e kryera e tejshkuar. Ndërkaq, e ardhmja sajohet në mënyrë perifrastike dhe paraqitet me dy lloje: nga pjesëza do+lidhore e tashme: *do t'skoj* dhe me foljen ndihmëse kam+paskajore *kam me shkue*. Kjo e fundit ka një përdorim më të shpeshtë. Koha e tashme e dëftores si dhe e lidhore përdoret në vend të së ardhmes kurse për të ardhmen e përparme përdoret vetëm një trajtë, pra kemi: do+lidhorja e kryer: *do tkēt* (<*ketā*) *ārđ*. Përdoret edhe mënyra lidhore e ardhme si p.sh.: *t kēš me ārđ*. Autori përshkruan edhe mënyrën lidhore, dëshirore, habitore e urdhëore. Pjesorja e shkuar pësore sajohet në tri mënyra, me prapashtesat: 1. *t(<*-tā)*, 2. *-m* dhe 3. *-un*. Pjesorja e tashme përbëhet nga pjesëza *tue* dhe trajta e pjesores së shkuar pësore, pra nuk është përcjellore. Paskajorja del në dy mënyra: paskajore e tashme veprorë *me ċit*; *me šit*; etj., dhe paskajore e kryer veprorë, e cila përbëhet nga dy pjesë: nga pjesëzat *me* dhe *pa*.

Nga fusha e sintaksës vlen të veçohen mënyrat e përdorimit të trajtave të shquara e të pashquara, përdorimi i rasave (gjinore, dhanore, kallëzore, rrjedhore), prafjalëve, pjesëzave (mohuese), lidhëzave. Në këtë të folme, përdoren fjalitë pyetëse, llojet e fjalive të nënrenditura (fjalitë lidhore, kundrinore, fjalitë kohore, krahasuese, rrjedhimore, shkakore, qëllimore, kushtore, lejore). Autori dallon tri periudha kushtore: periudha reale, e mundësisë dhe joreale.

Monografia “Dialekti i Dushmanit” ka një rëndësi të veçantë për dialektologjinë shqiptare të asaj kohe dhe të kohës së sotme sepse përmes saj filluan të bëhen edhe shumë studime të tjera për të folmet e shqipes. Ajo ishte një vepër studimore e kompletuar dhe që u bë model edhe për monografi të tjera dialektologjike pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse kushtet teknike në atë kohë nuk ishin të avancuara, arriti ta bënte përshkrimin e tërësishëm fonetik të kësaj të folmeje.

Në punimin *Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoevropiane*¹, Cimohovski sqaron se vendi i ilirishtes duhet të bëhet në bazë të fakteve të vetë gjuhës ilire dhe se duhet ndërtuar tek emrat gjeografikë dhe emrat e personave dhe materiali gjuhësor të kufizohet në Shqipërinë e sotme, në

¹Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoevropiane, SF, 2, Prishtinë, 1973, f.29-32

provincën e Dalmacisë, në Panoni, në Dardani, ku fiset ilire kufizoheshin me ato trake. Ai kundërshton tezën e Barić-it se karakteri satem i ilirishtes u bë nëpërmjet analizës së maqedonishtes. Cimohovski thotë se territori maqedonas ka qenë i përshkruar nga ilirët.

Studimi i tij mbështetet mbi problematikën e sandhit në zhvillimin e shqipes, gjegjësisht mbi zhvielimin e konsonanteve i.e. *g(h)* dhe *d(h)*. Ai sqaron se zhvillimi i këtyre tingujve ka qenë i kushtëzuar nga kushtet fonetike, pra depalatalizimi duhej të ndodhte në fqinjësi me *r*-në, pra *dh* pas *r*-së nëse paraprihet një zanore e patheksuar dhe para një *i*-je velare, ndërkaq *d* kemi pas *n*-së dhe në mes të fjalës. Me këto fakte, vjen në përfundim se “ilirishtja ballkanike nuk ka qenë as gjuhë satem e as kentum, përkundrazi ajo duhet përjashtuar nga ky grupim tradicional. Ajo formon një grup të mëvetësishëm, ku duhet të renditet edhe shqipja sepse edhe kjo shfaq tipare të ngjashme në historinë e sistemit të saj fonologjik¹.

Cimohovski i kushtoi rëndësi edhe origjinës së gjuhës shqipe². Rreptësisht kundërshtoi tezën e Weigand-it se shqipja është pasardhëse e e trakishtes, ku emrat topikë sidomos të fshatrave nuk mund të trajohen si emra që ekzistojnë në shqipen pandërprerë dhe nuk iu nënshtrohen ligjeve të zhvillimi fonetik të saj (shqipes). Përkime leksikore trako-sllave janë të pakta si b.f: *mantia* shq. “*man, mën*”; dak. *Οχιάον* “*gjëmbaç* shq. *çjerr, shkyej, gërryey* < **skernoo*”³.

Më tej ai shton se gjuha shqipe ka marrëdhënie të vjetra gjuhësore me sllavishten e baltishten dhe rendit disa formime të ngjashme me këto gjuhë, si: dezaspirimin (shfrymëtimin) IE *bh, dh, gh* dhe nyjëtimi i tyre me IE *b, d, g* si në shqipen ashtu edhe në balto-sllavishten; numërorët prej 11-19 dhe leksikun. Gjithashtu ka përngjasime ndërmjet bullgarishtes, maqedonishtes e rumanishtes me shqipen tek nyja postpositive (prapavendosëse) si *mik-u*; tek mënyra e formimit të futurit ku në shqipen jugore kemi: *do të shkruaj*, bullg. *šta da piša etj.*, shqipja dhe rumanishtja kanë bashkëpërkime fonetike e leksikore, por edhe përngjasime ndërmje folklorit. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se njëra është pasardhëse e tjetrës dhe e kundërta. Ndikimi i shqipes në gjuhën rumune, na bën të pranojmë se vendi ku u formua shqipja shtrihej edhe më larg se mendohej, kryesisht në drejtim të qyetetit të vjetër *Naissos* (sot Nishi). Pra, shqiptarët dhe rumunët në territorin e Ballkanit shtriheshin në trekëndshin Sofje-Shkup-Nish dhe kështu pas ardhjes së sllavëve ata u ndanë: stërgjyshërit e shqiptarëve u drejtuan në perëndim ndërsa stërgjyshërit e rumunëve në lindje. Gjuha shqipe edhe pse është gjuhë satem, ajo ka ruajtur gjurmët e kuantitetit të labiovelareve i.e. në pozicion para zanoreve i.e. Izoglosat iliro-shqipe leksikore e prapashtesore dëshmojnë për kuantitetin e ilirishtes në shqipen apo të prejardhjes së shqipes nga ilirishtja. Gjuha e ilirëve ballkanikë ishte satem ku del velarizimi i palataleve me një intensitet të ndryshëm në të gjitha gjuhët indoevropiane satem.

Ky studiues, shkroi për sistemin gramatikor të shqipes së sotme që nga fonologjia, morfologjia (emri-lakimi i tij, formën e shumësit të emrave, emrat mashkullorë e femërorë, përemrat dhe llojet e tij, mbiemrin, ndajfoljet, foljet-veçoritë gramatikore)⁴etj. Theksi në shqipen është ekspirator përveç disa përjashtimeve. Ai muar edhe me toponiminë shqiptare, me marrdhëniet gjuhësore shqiptare-sllave, fjalëformim e etimologji.

Vaclav Cimohovski hyn në radhën e atyre albanologëve, i cili me studimet e tij është i njohur gjithandej Evropës dhe për studiues të huaj të tjerë e shqiptarë që u morën me gjuhën shqipe në përgjithësi.

¹Po aty, f.44

²Prejardhja e gjuhës shqipe, BUSHT, SSHSH, 2, Tiranë, 1958, f. 37-40.

³Po aty, f.52

⁴Gjuha shqipe, Prishtinë, 1988, f.5-99.

Kontributi i tij është mjaft i çmuar sepse me studimet e tij dha argumente bindëse se shqipja është një gjuhë e vjetër i.e. dhe e trashëguar nga ilirishtja.

Bibliografia

Cimochowski, Wacław. Le dialecte de Dushmani, description d'un des parles d'Albanie du nord, Poznańskie Towarzystwo Przyjaciół Nauk. Prace Komisji Filologicznej, XIV, 1, Poznań 1951.
Pozicioni gjuhësor i ilirishtes ballkanike në rrethin e gjuhëve indoevropiane, SF, 2, Prishtinë, 1972.
Prejardhja e gjuhës shqipe, BUSHT, SSHSH, 2, Tiranë 1958.
Gjuha shqipe, Prishtinë, 1988.